

SHËJZAT

pleiades ★ 2017 ★ 3-4

Korrik-Dhjetor 2017

July-December 2017

P Ë R M B A J T J A Content

	Faqe Page
EUTERPE	
Mikaela Minga <i>Praktika shumëzërëshe në Shqipëri dhe itineraret e një asemi kulturor . . .</i>	5
Nicola Scaldaferrì <i>La canzone urbana di Shkodër e il canto epico del nord: un incontro con Ramadan Sokoli nel luglio del 1999</i>	18
Eno Koco <i>The Iso(n)—a Participatory Component in the South Albanian Multipart Unaccompanied Singing and in Byzantine Chant</i>	26
HISTORICA	
Matteo Mandalà <i>Kadare e gli altri: esempi di letture d'autore</i>	33
Bardhyl Demiraj <i>Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Urban</i>	43

Lucia Nadin	
<i>Custodi di memoria: l'immenso patrimonio degli archivi veneziani per la storia di Albania</i> 91
Italo Sarro	
<i>Identità albanese nelle carte degli archivi vaticani</i> 104
Carlo Pardi Suma	
<i>I documenti sugli affari albanesi nell'Archivio della Farnesina (1919-1945)</i> 113
Krisztian Csaplar	
<i>Der schwierige Anbeginn der Staatsbildung in Albanien: Der Konflikt zwischen Ismail Qemali und Esat Pasha Toptani 1913</i> 137
Rovena Sakja Godo	
<i>Peizazhe shqiptare në faqet e Rivista Mensile të Touring Club Italiano</i>	. 164
Evalda Paci	
<i>Trashëgimia arkivore françeskane, një vlerë e paçmuar në arsenalin e dijes shqiptare</i> 174
Marenglen Kasmi	
<i>Shqipëria në arkivat gjermane: fondet arkivore, përdorimi dhe veçoritë e këtij dokumentacioni</i> 185
David Hosaflook	
<i>Arkivi i Shoqërisë Biblike dhe arkiva të tjera "protestante" si burim për historinë moderne shqiptare</i> 201
Sokol Çunga	
<i>Fondi "Mark Harapi" i AQSh dhe përkthimi i panjohur i Dhiatës së Re dhe disa prurje të reja nga Arkivi i Autoritetit për Informimin me Dosjet e Sigurimit të Shtetit</i> 212
Gjovalin Çuni	
<i>Arkivi françeskan në bibliotekën "Marin Barleti", Shkodër. Një vështrim panoramik</i> 221
Pranvera Teli (Dibra)	
<i>Diplomaci në kushtet e Luftës së Ftohtë. Komiteti i Marrëdhënieve Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme dhe propaganda</i> 228
Andi Rembeci	
<i>Dokumentet pasbizantine të AQSh-së: rasti i kodikut të Korçës nr. 99</i> 245

PËRVJETOR

Anila Omari

Gjuha shqipe e teksteve të vjetra në studimet e Rexhep Ismajlit 265

Evalda Paci

*Kontribute të Rexhep Ismajlit në fushë të studimit
të teksteve të vjetra shqipe* 279

**Albanian landscapes in the pages of *Rivista Mensile*, published by
Touring Club Italiano**

Abstract: *Touring Club Italiano is an association of cyclists and nature enthusiasts. It has promoted for over a century now environmental and cultural consciousness, the discovery of natural attractions, the protection of historical and artistic heritage. It has as well promoted different countries and cultures too. Touring Club has over the years also devoted special attention to the press. In fact, it has regularly published periodicals since 1895.*

*The following essay focuses on four reportages published in the *Revista Mensile*, from 1911 to 1919, and it aims to offer scholars interested in Albanian history more detailed information on the tools of communication, description of the territory and of the landscape, without neglecting opinions and facts about the traditions and the customs of the locals. Exploring a long swathe of Albanian territory – from Shkodra to Vlora – these reportages are a valuable source of information about the-then Albania.*

Touring Club Italiano¹ u themelua më 8 nëntor 1894 me qëllim promovimin e vlerave ideale dhe praktike të çiklizmit e të udhëtimit dhe dallohet për dedikimin në “zhvillimin e turizmit si mjet njohjeje i vendeve dhe kulturave të ndryshme, i mirëkuptimit reciprok dhe i respektit mes popujve. Në veçanti TCI synon të bashkëpunojë për tutelën dhe edukimin e përdorimit korrekt të trashëgimisë kulturore, historike, artistike e natyrore, të cilat vlerësohen si pasuri e pazëvendësueshme që u duhet trashëguar brezave të ardhshëm”²

Përgjatë historisë së tij njëqindvjeçare Touring Club është bërë përcues i vlerave që kanë në qendër respektimin e ambientit kulturor e natyror, ka ndjekur objektiva të zhvillimit turistik, duke mbështetur veçanërisht zbulimin e bukurive artistike e mjedisore më pak të njohura e të frekuentuara, si dhe mbrojtjen e trashëgimisë historike, kulturore e natyrore, duke i bërë turistët të ndërjegjshëm për rëndësinë e tyre për të ardhmen.

1 TCI

2 <http://www.touringclub.it/chisiamo/la-nostri-storia>.

Si pasojë e veprimtarisë intensive publicistike dhe studimore, TCI ka arritur të mbledhë një pasuri të rëndësishme dokumentare që ka gjetur sistemim në Centro Documentazione³ – Qendra Dokumentare e TCI, ku mund të gjenden libra, revista, materiale kartografike, fotografi, kartolina, vizatime por edhe targa, medalje e objekte të ndryshme të cilat datojnë që nga 1894. Koleksioni, i rrallë në llojin e vet, ka si objektiv ruajtjen e përhapjen e njohurive ambientale, gjeografike, turistike e kulturore.

Që nga themelimi tij, Touring Club i ka kushtuar vëmendje të veçantë aktivitetit editorial, ku një vend të rëndësishëm zë botimi i hartave, atlaseve, udhërrëfyesve. Më pak të njohura, deri më sot të paktën, por po aq të rëndësishme, janë revistat e publikuara me kadencë mujore që nga viti 1895. Një trashëgimi me përmasa të konsiderueshme – thuajse 200.000 faqe – që ruhet me perkujdesje në arkivat historike të Cedoc.

Këto arkiva ruajnë edhe dokumentacion të prodhuar apo të ardhur në mënyra të ndryshme në TCI që nga data e themelimit: një korpus dokumentar heterogjen që mbulon tematika shumë më të gjëra se vetëm turizmi. Bën pjesë këtu dokumentacioni i prodhuar gjatë aktivitetit institucional të organizatës, por edhe vizatimet dhe skicat origjinale për revistat e Touring: rreth 1000 krijime të ilustruesve e artistëve më në zë, nga fillimet e '900 deri në vitet '60. Nuk mund të lihet pa përmendur dhe arkivi fotografik, që përmban 350.000 stampa bardhë e zi që dokumentojnë peizazhin italian por jo vetëm, të realizuara nga artistë të mëdhenj të fotografisë por edhe nga amatorë të apasionuar.

Një tjetër objektiv i TCI që në fillimet e tij, ka qenë promovimi i njohjes së vendeve e kulturave të ndryshme, si dhe përhapja e një fryme mirëkuptimi e respekti reciprok mes popujve, duke arritur nëpërmjet kësaj emancipimin civil e kulturor të individëve.

Pikërisht në këtë prizëm duhen vlerësuar artikujt e dedikuar Shqipërisë, të publikuara në faqet e periodikut “mëmë” të publikimeve të Touring Club Italiano, *Rivista mensile – Revista Mujore*,⁴ e publikuar nga 1895 deri në 1920: fillimisht si një buletin informacioni i rezervuar abonentëve të organizatës, që me kalimin e viteve erdhi duke u pasuruar në numër faqesh e në përmbajtje.

Nga kërkimet arkivore rezulton se artikulli i parë, dedikuar Shqipërisë është botuar në numrin e korrikut të 1911, me titull “*In Albania. Cenno sulle comunicazioni albanesi*”⁵ – “Në Shqipëri. Shënime mbi komunikimet shqiptare” me autor Arnaldo Cipolla⁶.

3 Cedoc.

4 Nga 1917 shoqërohet nga suplementi Le Vie d'Italia, e cila që nga 1920 e zëvendëson plotësisht revistën.

5 Rivista Mensile del Touring Club Italiano, Anno XVII, nr.7, luglio 1911, pp. 361 – 366.

6 Arnaldo Cipolla 26 shtator 1877 - 25 shkurt 1938. Fillimisht i dedikohet karrieres

Cipolla, përshkrimin e tij të linjave komunikuese e ndërlihdhëse të Shqipërisë e fillon me disa përshtypje për revoltën shqiptare ndaj trupave turke të Turgut Pashës. Sipas autorit “...il carattere della presente insurrezione ed i fini che la provocarono e che l'alimentano non sono precisamente quelli di un popolo che combatte per un'idealità nazionale...”.

Autori thekson se analiza e revoltës nuk është synimi i artikullit, sepse kjo do të tejkalonte qëllimet e revistës dhe natyrën e saj, por gjithsesi nuk mungon të shprehë opinionin e tij se do të kishte qenë e dëshirueshme për Italinë që Shqipëria të mbetej, siç ishte tendencë shekullore e saj, nën sundimin turk, sepse një Shqipëri autonome, do të ishte e destinuar të favorizonte programet ekspansioniste të fuqive me interesa të kundërta me ato të italianëve.

Sipas autorit në të njëjtat konkluzione mund të arrihej edhe pa u marrë domosdoshmërisht me politikë ballkanike, por thjesht duke analizuar kontradiktat e brendshme të revoltës shqiptare, të cilat ai vetë i kishte rregjistruar duke filluar nga Podgorica “...invasa da esuli e quartier generale degli insorti...”, në Shkoder “...pavida pel terror di temuti massacri...”, e më tej në Durrës “...triste rovina immersa in una opprimente atmosfera di grandezza...”, për të arritur deri në Vlorë “...sonnolente di malaria o di abbandono...”.

Autori kishte udhëtuar përgjatë Egnatias “...la via sacra albanese dove primariamente s'incontrarono gli uomini d'oriente con quelli dell'Occidente e che fu poi traversata dai legionari di Paolo Emilio e di Pompeo...” deri në liqenin e Ohrit “...azzurro specchio...che riflette gli scoscesi pendii del antico Parnaso ed ospita tranquilli pastori ignari della lotta ingaggiata poco lungi da loro, assorti nelle cantilene modulate dalle loro zampogne che ripetono le nenie dell'eterno Pan ellenico...”.

Për Cipolla-n, revolta shqiptare ishte e paorganizuar e pa drejtim dhe përshkruan kështu pasojat e përplasjeve të armatosura:

“...Nelle lunghe soste quotidiane sembra di aver dinanzi un deserto. Non rimangono che i villaggi che fumano, fumano sempre, come se nel luogo dove essi sorgevano si fossero aperti dei crateri di vulcano. Incombe sulla piana una malinconia così tetra e profonda che lo spirito si immerge e si smarrisce nel dolore ineffabile che proviene dagli uomini ribelli, che deriva dalla pietà che infondono anche quegli oppressori inconsci, raccolti intorno alle bandiere inerti lungo le aste, che è ispirato dalla tristezza sepolcrale delle montagne sassose, dalla pianura deserta ed incolta sulla quale dopo il

ushtarake. Në vitin 1904 niset vullnetar në Kongo dhe nga korrespondenca me familjen lind publikimi i pare “Dal Congo”. Më pas punësohet në Corriere della Sera si korrespondent nga Afrika. Ndoqi operacionet e trupave italianë në Somali e Etiopi. Në vitin 1910 punësohet në La Stampa ku mbuloi veçanërisht fushatën e Libisë. Udhëtoi e shkroi shumë, veçanërisht në periudhën mes dy luftërave botërore. [http://www.treccani.it/enciclopedia/arnaldo-cipolla_\(Dizionario-Biografico\)](http://www.treccani.it/enciclopedia/arnaldo-cipolla_(Dizionario-Biografico)).

fragore delle artiglierie stride il gracchiare sinistro dei corvi...

Në Shkodër autori gjeti një tjetër atmosferë mes elitës shqiptare, produkt i shkollave evropiane, ndaj të cilës ai mban qëndrim kritik: *"...non uno andava ad unirsi agli insorti. Non uno, e ve n'eran di ricchi, dava un obolo anche insignificante alla causa ed agli affamati esuli nel Montenegro..."* për të vijuar akoma më tej: *"...Scutari non vede nulla. Percepisce della rivolta una sensazione simile a quella dei prigionieri rinchiusi nella stiva di un bastimento in lotta con la tempesta ha udito il rombo lontano, indistinto delle artiglierie, ma non ha visto un ferito..."*

Kontradikta që autori vërente në organizimin e revoltës shqiptare, dilte akoma e më shumë në pah kur apatisë së elitave qytetare shkodrane i kundërvijehet përshkrimi i banorëve të malit, të cilët për të ishin interpretuesit më të natyrshëm të karakteristikave të territorit.

Autori tenton të zbulojë rrënjët etimologjike të *Adetit* shqiptar duke e krahasuar me *mos*-in latin dhe *ethos*-in helen: *"...Li adet risponde al senso intimo del mos latino e del ethos ellenico con la differenza che il vocabolo latino esprime la legge della maggioranza, l'ellenico quello della convenienza estetica e morale, laddove l'adet albanese è la manifestazione di una legge uniforme comandata dai tempi, dal terreno, e dagli uomini..."*

Cipolla i sjell lexuesve shembullin e Mirditorëve, që për të mbrojtur autonominë dhe fenë e tyre katolike, u organizuan në republikë ushtarako- aristokratike: *"...con statuti e pratiche che stimolarono l'individualismo degli spiriti, la tenacia degli odi e delle vendette..."*

Shtegtimi i Cipolla-s në Shqipëri vijon duke zbritur në luginën e Shkumbinit, hapësire tranziti ku autori nuk mungon të vërë në dukje praninë autoritare të rrënojave të kullave, që në lashtësinë romane e bizantine mbronin karvanët që kalonin nga Adriatiku drejt Egjeut, nëpërmjet Shqipërisë, e cila mbante në zemër *"...una delle vie maestre più antiche dell'umanità, la Via Egnatia...si distingue da tutte le altre vie di penetrazione balcanica per aver rappresentato in ogni tempo il vincolo più rapido ed efficace tra la civiltà orientale e la occidentale..."*

Duke marrë shkas nga dëshira e përfolur e xhonturqve që evropianët ta kthenin këtë arterie komunikative në linjë hekurudhore, Cipolla analizon kushtet e rrjetit rrugor në Shqipëri, e cila konsiderohej *"...come la peggiore esistente in territori europei..."* dhe objektivisht përbënte shkakun kryesor të prapambetjes ekonomike të vendit. Analiza merret me klasifikimin e rrugëve të Shqipërisë, duke marrë për bazë kriteret e përdorura nga administrata turke:

- "rotabili" rruge të kalueshme nga mjetet lokale "arabas";
- "mulattiere" rrugë të kalueshme me kafshë transporti;
- rrugë malore.

Pjesa mbizotëruese e rrugëve të vendit ishin të kalueshme pjesërisht nga karroca e kafshë transporti dhe në përgjithësi ishin të karakterizuara nga trajektore të komplikuar, kthesa të forta dhe bazament jo uniform. Për shkak të vështirësive të profilit topografik të rrjetit rrugor, mungesës së sigurisë së urave e të tjera të papritura, autoritetet i detyronin udhëtarët të pajiseshin me udhërrëfyes. Cipolla bën të qartë se këta ishin “...guide e non scorte...”, duke theksuar që brigantizmi ishte fenomen i panjohur në Shqipëri sepse “...lo straniero che percorre le montagne albanesi dove s’addensano le bufere che scendono impetuose ad agitare l’Adriatico allo schermo della protezione o dell’assistenza giuratagli anche dal più umile degli conterranei, non può essere impunemente toccato da chicchessia senza incorrere nell’odio implacabile delle vendette familiari e collettive...”

Në vijim të analizës së rrjetit ndërlidhës në Shqipëri, Cipolla merret me gjendjen e urave, të cilat ishin të pakta në numër, trajektoren e rrjetit rrugor shqiptar dhe identifikimin e 4 grupeve të linjave komunikuese duke u nisur nga bregdeti drejt pjesës së brendshme të vendit:

- komunikimet mes Ulqinit, grykëderdhjes së Drinit dhe basenit Gjakovë-Prizren.
- komunikimet mes grykëderdhjes së Drinit, Durrësit, Elbasanit, Ohrit e Manastirit.
- komunikimet mes Vlorës, Elbasanit, Ohrit e Manastirit.
- komunikimet mes Vlorës, Beratit dhe Gjirit të Artës.

Reportazhi shqiptar i Cipolla-s përfundon me përshtypjen se shqiptarët akoma nuk e dinin cila mund të ishte qoftë edhe përafërsisht drejtimi dhe e ardhmja e tyre, por në mënyrë të pavetëdijshme prisnin një dorë të fuqishme që t’u jepte një identitet kombëtar. Por që prej 25 vjetësh kontakti i shqiptarëve me botën e qytetëruar kishte qenë aq sipërfaqësor, saqë e bënte me të vështirë rigjenerimin e identitetit të tyre.

Artikulli paraqet interes edhe për materialet fotografike që e shoqërojnë, rreth 13 fotografi që shënojnë etapat e udhëtimit të autorit: kampet e ushtrisë turke të dërguara në Shqipëri për të shtypur revoltën; shpërndarja e armëve tek të rinjtë myslimanë të Shkodrës; portrete të vajzave mirditore e grave katolike; pamje nga Shkodra, Prizreni, Vlora, Durrësi, Elbasani e Tirana.

Cikli i reportazheve të udhëtimit me tematikë nga Shqipëria vijon në vitin 1913 me artikullin e Paolo Revelli “Scutari e l’Albania?”. Artikulli hapet me përshkrimin e kontureve të qytetit, të shënuara nga bashkëjetesa e elementeve gjeografikë, kulturorë e historikë shumë të ndryshëm mes tyre: kishat dhe minaret; profilet e ashpra të Alpeve dhe luginat e gjelbëruara të Drinit të poshtëm e të Bunës, dhe reliket e fortesës “serbe” të Rozafës

që sipas autorit ishte kujtesë e lavdisë së Stefan Dushanit “Car i serbëve, grekëve dhe shqiptarëve”.

Artikulli rradhiti ngjarjet kyçe në historinë e qytetit: rrethimin e Shkodrës dhe lulëzimin e saj si koloni romake, furinë grabiqare të gotëve dhe dyndjen dërrmuese të serbëve, sundimin e gjatë venecian, të ndërprerë përkohësisht nga një zotërim hungarez, dhe në fund rënien nën pushtimin osman më 1447. Ngjarje që ishin shtresëzuar në kujtesën e qytetit, rigjallëroheshin kryeneçe në gojëdhënat dhe shfaqeshin para udhëtarit ashtu siç parakalonin, mbështjellë në veshjet tradicionale të të parëve të tyre, bijtë krenarë të shqiptarëve. Kjo stafetë sundimtarësh ishte reflektuar edhe në ndryshimet që kishte pësuar vetë emri i qytetit: *Scutari* për italianët, *Skadar* nën serbët, *Iskodra* nën turqit, ndërsa shqiptarët ruanin akoma emrin e lashtë *Skodra*.

Në vijim Revelli i kushton vëmendje përshkrimit të karakteristikave hidrografike të Bunës e Drinit, dhe të efekteve shkatërruese të Kirit, të cilat bashkë me mungesën e skelave në bregun e largët vetëm 25 km, nuk e kishin lejuar qytetin të arrinte potencialin e premtuar nga pozita gjeografike.

Megjithatë, falë vendndodhjes në udhëkryq të rrugëve, të cilat nga Danubi dhe Egjeu drejtoheshin për në Novi Bazar për të zbritur në Adriatik, Shkodra filloi të afirmohej duke nisur nga fundi i mesjetës.

Duke lënë pas Shkodrën me disa informacione për familjet dhe bajraqet e zonës: Kastrati, Shkreli, Kelmendi dhe Mirditët, artikulli vijon përshkrimin unitar të territorit të Shqipërisë – e gjatë pak më shumë se 420 km, e gjerë mesatarisht 100 km dhe e paqartë në kufijtë e saj etnografike. Në jug sipas autorit ishte më i përfaqësuar elementi helenik, ndërsa elementi shqiptar ishte më i pranishëm në zonën e lindjes, në Serbinë e vjetër, në Maqedoni e në një pjesë të Thesalisë.

Nuk mungojnë informacionet rreth teorive në qarkullim mbi origjinën e emërimit të shqiptarëve: “...*Esso appare per la prima volta nëgli scrittori bizantini, poco dopo il mille, quando ancora approdano al porto di Durazzo le vele amalfitane...*” dhe vihet në dukje që më së shumti, të paktën prej 8 shekujsh, emërtimi “*albanesi*” u takonte banorëve të malit, të cilët për nga mënyra e jetesës dhe aspiratat dalloheshin dukshëm nga banorët e bregut, ku rreth 85 km nga Otranto dhe 125 km nga Brindizi, ngrihej: “...*Valona, tanto più importante di Parga che domina l’ingresso del golfo di Arta...*”

Revelli përshkruan pyjet e Shqipërisë dhe tipologjitë e drurëve që rriteshin në to; luginat e kultivueshme, shumëllojshmërinë e formave, prodhimeve dhe kushteve klimaterike për të vazhduar me informacione mbi linjat e komunikimit ekzistuese e ato të planifikuara si psh.hekurudha Vlorë-Selanik, linja lidhëse e Shkodrës dhe Shëngjinit me hekurudhat serbe, dhe ajo e Durrësit me linjën Manastir-Selanik. Këto projekte akoma nuk dukeshin në horizont por autori shprehte besimin që nuk do të ishte e

largët dita në të cilën një rrjet rrugor i përshkrueshëm nga automjetet, do të lejonte turistë të shumtë në numër, të shijonin bukurinë e egër të maleve shqiptare, në të cilat kacavirreshin shtëpi piktoreske e të pakta në numër.

Në rrugëtimin e tij autori gjen aty këtu shenja të mbijetesës së gjuhës dhe aktivitetit italian, por vë në dukje faktin se shkëmbimet tregtare me bregun salentin ishin të rralla dhe ky ishte element kritik për nivelin e angazhimit italian në Shqipëri.

Shtegtimin shqiptar Revelli e përfundon duke vënë në dukje se vendimi i shqiptarëve për të luftuar përkrah turqve dhe kundër fqinjëve ishte në funksion të mbrojtjes së tokës së tyre, ideal për të cilin ata kapërcenin edhe dasitë krahinore, gjuhësore e fetare⁸.

Duhet të kalonin 5 vjet që Shqipëria të ishte objekt i një tjetër reportazhi në faqet e Revistës Mujore të TCI, në numrin e gushtit 1918, një artikull me firmë të Bruno Astorit, i titulluar "Valona"⁹. Impakti i parë me qytetin nuk është entuziazmues për autorin, i cili kur gjendet para "... *questa verde, piatta, silenziosa baia di Valona...*", pushtohet nga një ndjesi e papërcaktueshme zhgënjimi.

Ndoshta sepse me një emër të tillë "*...dal buon conio romano, dal ritmo largo, pieno, sonante, Valona era nata nella mente con la figura di un'aquila bianca, appollaiata su uno scoglio che si avanzasse nel mare a guisa di un'alta prora, con un suo scenario di mura merlate...come quelle castella levantine o dalmatiche di cui Venezia ha ingioiellate le rive dell'Adriatico e dell'Egeo...*".

Këto ishin pritshmëritë e udhëtarit që kishte akoma para syve madhësitinë e Akleionit dhe shkëlqimin perandorak të Splitit "*...e invece... invece nulla*". Sepse edhe imagjinata e udhëtarit më modest do të ishte zhgënjyer gjithashtu: "*...tra le pendici delle lontane colline e o specchio delle vicine paludi, un breve greto di spiaggia, con tre o quattro bianchi, bassi, poveri edifici...si era a Valona*".

Megjithatë autori informon lexuesin se qyteti, përgjatë dy qytetërimeve, romak dhe atij venedikas, kishte qenë një bazë detare jo pa rëndësi dhe vijon në përshkrimin e Vlorës: "*...bianca, bassa, vasta con i suoi orti che rompono la monotonia dei muri calcinati; con i suoi minareti agili e puntuti; con i suoi cipressi che sembrano altrettanti minareti verde-bruni...*".

Astori përshkruan edhe atmosferën e qytetit "oriental" që ndodhej vetëm 40 milje distancë nga Italia, një hap larg qytetërimit dhe jetës së ethshme të Evropës, e megjithatë dukej sikur mërzhitej prej kohësh që s'mbaheshin mend, dhe as ngjarjet më të fundit nuk mundeshin ta zgjonin nga "apatia piktoreske".

Pikërisht apatia dhe minaret e bënin piktoreske Vlorën, që gjithsesi arrinte ta shpërblente mundin e shtegtarit. Nga Janina, kur binte velloja

8 Artikulli është i pajisur me material të pasur fotografik.

9 Rivista mensile del TCI, Anno XXIV nn.7-8, luglio agosto 1918, pp. 143-149.

e mjegullt që në mëngjes i mbulonte “fytyrën e bardhë myslimane”, Vlora shfaqej në gjithë bukurinë e saj cigane: për pak çaste udhëtari mbetej i përhumbur në admirim.

Por mesdita ishte kohë falje në Orient dhe në të gjithë minaret e qytetit shfaqeshin hoxhallarët, që me zë ankues i këndonin lavde Allahut, një melodi melankonike që shënjonte ritmin e jetës në Vlorë. Jeta e ngadaltë, e heshtur, e padukshme zhvillohej e gjitha në sheshin e pazarit, në mëngjes kur zbrisnin barinj të nga Mallakastra, kur paria e qytetit shkonte në kafene e uleshin të gjithë në rradhë përgjatë mureve, në stola të stërgjatë, pa tavolina përpara, duke rrufitur pijen e aromatizuar, duke soditur kalimtarët e rrallë e duke diskutuar përtueshëm për politikë.

Politika ishte sëmundja e përbashkët e shqiptarëve të Gegërisë dhe Toskërisë. Të rehatuar në fluskën e lirisë që qeveria e Stambollit u kishte dhënë për t'i mbajtur urtë e butë, nuk ishin lodhur për vite e vite me rradhë duke lidhur e zgjidhur me muhabet, para kafesë, çështjet politike, organizimin shtetëror, ekuilibrat e aleancave me shtetet fqinje. Kishte ardhur pavarësia, e pasuar nga Principata e Vidit, por diskutimet politike në kafene nuk kishin sosur.

Astori përshkruan sjelljen e parisë politike shqiptare, e cila kur vendi digej udhëtonte në Evropë e Amerikë duke frekuentuar hotele luksoze. Ishin “...*politicanti senza politica, dei diplomatici fuori della diplomazia...*”. Me keqardhje vërehet se, edhe pse e pasur në burime natyrore, Shqipëria mbetej vendi më i varfër në Evropë: “...*per lo stato di incuria, d’abbandono, d’inerzia in cui era lasciata...*” dhe sipas autorit problemi qëndronte në faktin se për 90% të popullsisë puna nuk ekzistonte, të paktën “puna në kuptimin evropian të fjalës”.

Autori nuk harron të vërë në dukje edhe gjendjen e gruas, e cila në shoqërinë shqiptare jetonte në “...*segregazione quasi assoluta...*” aq\sa mund të frekuentoje për vite të tëra shtëpinë e një beu apo nje borgjezi mysliman e të mos kishe pasur nderin të njihje zonjën e tij.

Artikulli sjell informacione mbi linjat ndërlidhëse detare dhe tokësore të qytetit me Italinë dhe pjesën tjetër të vendit, për të kaluar tek paragrafët me karakter historik: nga trashëgimia romake “...*il più importante e più fulgido periodo della loro storia...*”, tek përfshirja në kurorën bizantine, moment ky që sipas Astorit përcaktoi fillimin e dekadencës së Shqipërisë, e cila për shumë shekuj perceptohej si një njollë e errët gjeografike, pa konture e karakteristika të veçanta, me përjashtim të elementit identitar gjuhësor.

Ishin alternuar në territorin shqiptar venedikasit, anzhuinët, serbët, feudalët lokalë e pushtuesit turq, por veçohet influenca “...*mite, saggia e generosa...*” e Venecias, me të cilën Shqipëria bregdetare përjetoi një qytetërim të dytë. Reminishenca të asaj periudhe dalloheshin në ndërtesat

më në pah të qyteteve bregdetare dhe në rastet jo të pakta të përdorimit të italishtes si gjuhë e dytë. Artikulli përfundon me vënien në dukje të faktit se si me zbarkimin e ushtarëve italianë, Vlora kishte ndryshuar faqe, ishte rinovuar, pastruar dhe kishte ndërmarrë rrugën e qytetërimit të tretë, një qytetërim italian pas atij romak e venecian. Një vëmendje të veçantë meriton edhe materiali fotografik që shoqëron artikullin.

Artikulli i fundit i marrë në shqyrtim është publikuar në vitin 1919 në faqet e "*Le Vie d'Italia*", që duke nisur nga viti 1917 publikohej si suplement i *Revista Mensile* dhe në vitin 1920 e zëvendësoi plotësisht. Artikulli "*L'Italia in Albania. Dalle mulattiere albanesi alle strade italiane*" i Pio De Flaviis¹⁰ kishte synimin të hidhte dritë mbi një sektor të veprimtarisë italiane në Shqipëri që sipas autorit ishte gati i panjohur – ngritja e rrjetit rrugor shqiptar.

Sipas autorit një ndjesi e tepruar modestie i kishte penguar italianët t'i njihnin vetes meritat për punën e kryer në Shqipëri, madje ata vetë dinin shumë pak mbi natyrën e gjerë e komplekse të veprimtarisë italiane në vendin fqinjë. Gjatë luftës, për këto çështje nuk mund të flitej, sepse nuk duhet të ishin të dukshme aspiratat italiane kundrejt bregut tjetër të Adriatikut, por edhe pas luftës kishte pasur një lloj ngurrimi e heshtjeje, ndoshta për të mos kompromentuar rezultatet e konferencës së Parisit. Shprehet kështu keqardhje që aktiviteti i kryer nga ushtarët italianë në Shqipëri lihej në harresë e kujtoheshin vështirësitë që hasën trupat e para italiane që zbarkuan në Vlorë: mungesë rrugësh, banesash, pamundësi komunikimi.

Asnjë vend tjetër i Ballkanit nuk përballej me mungesa kaq të theksuara në mjete komunikimi, të cilat mund të justifikoheshin me vështirësitë e relievit të ashpër malor të vendit, me prapambetjen që kishte lënë pas sundimi osman, por në një farë mase ishte e shkaktuar edhe nga qëndrimi armiqësor i vendasve ndaj çdo forme progresi.

De Flaviis vijon në përshkrimin e rrjetit rrugor të Shqipërisë që karakterizohej nga mungesa e hekurudhave, shumë pak rrugë të përshtatshme për qarkullimin e automjeteve ndërsa pjesa tjetër ishin "*mulattiere*"¹¹. Më tej vijon me përshkrimin e izolimit dhe të mungesës së komunikimit mes qyteteve shqiptare si p.sh. Vlorës dhe Durrësit, mes të cilave nuk ekzistonte një linjë direkte rrugore, ndërsa nga Vlora në Sarandë shkohej mes shumë peripecish: 18 orë me kuaj deri në Himarë, e më pas 12 orë deri në Sarandë.

Me këtë gjendje të rrjetit dhe transportit rrugor u përballën trupat italiane dhe sidomos trupat e Genio Militare, që studiuin problemin nga

10 Oficer i xhenios ushtarake, i cili gjatë viteve të luftës punoi në ndërtimin e rrjetit rrugor italian.

11 Shtigje, rrugë rurale të përshtatshme për transportin me kafshë.

pikpamja llogjistike, por duke pasur parasysh edhe nevojat e pasluftës. Përveç rrjetit rrugor një kujdes i veçantë u tregua edhe për kompletimin e veprave të tjera me dobi publike si p.sh instalimi i një ujësjellësi, i një impianti elektrik dhe i urës së Penkovës mbi Shushicë.

Pushtimi i Sarandës i dha një tjetër frymëmarrje Vlorës dhe përballi Genio Militare me sfidën e lidhjes së dy qyteteve nëpërmjet qafës së Llogarasë "*un passo... difficile*". Në ndërtimin e rrugës u angazhuan batalionet territoriale të XVI Corpo d'Armata dhe shumë trupa të Genio-s, duke arritur që vetëm në dy muaj të përfundohej ndërtimi i saj.

Por aktiviteti italian në Shqipëri nuk u kufizua vetëm në ndërlidhjet e Vlorës me qytetet fqinjë. Autori kujton kilometrat e dekovilit që përshkonin rrethinat e Vlorës e që i jepnin jetë e gjallëri portit të saj, përmend projektin e hekurudhës transballkanike Vlorë-Manastir, për të cilin shpreh habinë për heshtjen që e mbulonte dhe përfundon duke kujtuar që aktiviteti italian në Shqipëri nuk u kufizua vetëm në transportin rrugor por edhe në hapjen e shkollave, në zhvillimin e bujqësisë e në njohjen me rregulla të reja ekonomike e sociale. Edhe ky reportazh është i shoqëruar me materiale interesante fotografike.

Qëllimi i kësaj ekspozite është t'u ofrojë lexuesve, nëpërmjet risjelljes në jetë të përshtypjeve të udhëtarëve të TCI, që tashmë janë më se njëqind vjeçare, burime të reja dokumentare, të cilat ndoshta mund të frymëzojnë kuriozitetet e interesat të reja studimore.